



**Hazir Mehmeti, Vjenë**

**Kumtesë:** “Orë mësimore në klasën heterogjene”.  
Nga praktika mësimore

**Pjesa 1 :** Koncepti i përmbledhur metodik

**Lënda mësimore:** Gjuhë shqipe

**Klasa heterogjene:** Gr. 1 (Kl. 1); Gr. 2 (Kl-2,3,4 )

**Njësia mësimore:** Grupi i parë (klasa e parë) :  
Shkronja Dh/dh, kurse **grupi i dytë:** 2 (Kl-2,3,4).  
Gjëegjëza

**Qëllimi:** Të dalluarit e tingullit përkatës Dh, dh. Leximi  
i fjalëve dhe fjalive. Ndarja në rrokje e fjalëve, renditja

logjike e fjalëve. Formimi i aftësive gjyquese. Perceptimi figurativ dhe të shprehurit logjik.  
Vëmendja, të folurit e rrjedhshëm. Kuptimi i fjalëve, leximi, shkrimi, vetëformimi i një  
gjëegjëze, ushtrim tregimi.



**Forma e mëimit:** Në grupe

**Rrjedha**

**Hyrje:** Muzikë e lehtë apo ritmike 3-4 min. Nxënësit ulen në rreth dhe në mes vihen figura  
nga tema mësimore.

**Biseda:** 8-10 min. Nxënësit i shikojnë figurat me radhë. Fillon biseda me nxënësin rreth  
figurës së zgjedhur nga ai, të tjerët plotësojnë, bisedohet me të gjithë.

**Hyrje: Biseda**



**Leximi** (10-12 min) i gjëegjëzave dhe gjetja e emrit dhe figurës.

**Shkrimi** ( 10-12min) i fjalive nga teksti, tekst nga libri

**Reflektimi** (8-10min)

Nga të gjithë nxënësit lexohen me radhë gjëegjëzat, korrigojohen dhe vendosën në radhë.  
Gjendet figura përkatëse dhe vendoset pranë tekstit. Për shembull: “ Një patë qafëgjatë duke  
ikur bën shamatë”, pranë tekstit vendoset figura e aeroplanit.

Nga tekstet dhe figurat formohet përmbajtja të cilën e lexojnë nxënësit duke i ndërruar  
etiketat me shkrime e figura. Nga të gjitha gjëegjëzat, nxënësit mësojnë disa (dy-tri) prej tyre,  
i shkruajnë në fletore dhe vizatojnë figurën përkatëse. Gjëegjëza: “Dy vëllezër shohin tërë  
botë, vetveten nuk e shohin” – sytë, të cilët vizatohen. Kur ka mundësi interneti, nxënësit  
mund të kërkojnë gjëegjëza dhe i tregojnë para grupit

**Loja:** Lexohet gjëegjëza nga një nxënës, tjetri me mimikë, zë, ecje e ndihmon shokun që  
ta gjen.

- Nga shkrimet formohet teksti i plotë me gjëgjëza nga nxënësit. Grupi i dytë ndihmohet më shumë, për shkak të nivelit të tyre. Përpjekje për të mësuar gjëgjëzën e preferuar. Shkruaj gjëgjëzë.

**Detyrë shtëpie:** shkrimi i 3 gjëgjëzave me ndihmën e prindërve apo internetit

**Varianti:** Lexohen disa gjëgjëza dhe bisedohet rreth tyre. Vihen figurat, bisedohet rreth tyre duke krahasuar me tekstin artistik nga gjëgjëza.

**Pjesa 2:** Nga realizimi praktik



**Fillimi:** Në fillim të orës 4-5 minuta muzikë e preferuar. Kjo shton përqendrimin, aktivitetin psiko-motorik e logjik të nxënësit. Muzikë e lehtë ose muzikë për fëmijë.



**Biseda** ( 5-10 minuta).

Rreth temës bisedojnë të gjitha grupet (klasat) Secili Nxënës merr nga një figurë sipas dëshirë dhe flet disa fjalë rreth saj. Figurat janë nga tema: Gjëgjëza

Për shembull: Gjirafa ka qafë të gjatë .../ Breshka mban shtëpinë me vete.... / . Secili me radhë duke e plotësuar të tjerët.

**Grupi 1 :** Klasa e parë, punë në stacione

**Grupi 2-** të dhe **Grupi 3 –të , Klasa 4 -**

**Kl-1: Stacioni 1** Teksti, A-B-C Fibel Abetare (A). Tekst i standardeve bash-kohore për Alfabetim në Austri.

Bisedë rreth figurës së parë. Si quhet shtaza, ku jeton, është mishngrënëse, dinake etj. Me cilën shkronjë fillon emri i saj, emri në gjuhën e shkollës. Shkrimi sipas rregullit teknik, faqja fillestare e shkronjës Dh/dhe. Shkrimi sipas udhëzimeve me tri ngjyra, tërheqje sipas rregullit të caktuar (orientim sipas shigjetave) jo ngjyrosje.

## Stacioni 2

**Shkrim në tabelë,** 5 tërheqje me radhë në secilën shkronjë.



**Stacioni 3-** punimi i shkronjës me tel të veshur.

**Stacioni 4:** Kërkimi i shkronjës Dh/dh dhe renditja



**Stacioni 5:** kërkimi i shkronjës dhe vendosja e tyre në radhë.

Emrat e figurave me shkronjën dhe. Ku mungon shkronja të shkruhet dhe e të lexohet. Emrat përsëriten disa herë dhe ku ka vështirësi thuhet dhe në gjuhën e shkollës.

**Varianti:** Skanohet faqja me, zmadhohen ca figurat, shtypen, prehen, foliohen, prehen.

**Stacioni 6:** Faqe 3 Leximi. Nxënësit lexojnë fjalitë dhe rrethojnë shkronjën Dh, dh. Leximi i tekstit me radhë, theksimi i tingullit qartë, plotësimi i hapësirave brenda fjalive. Leximi vertikal, një formë e veçantë e cila ndihmon perceptimin e shkronjave në fjalë.

**Varianti:** Njohja me figurat e nxjerra nga teksti (faqe 2 e shkronjës).

**Loja:** Kush di më shumë emra. Shpërblimi: etiketë flutur, yll. Ai i cili bënë 10-të do shpërblehet me një flutur, yll (etiketë), sheqerkë etj.

Stacioni 6: - Përshkrimi në fletore kur nxënësi vizaton sipas dëshirës një figurë e cila fillon me shkronjën Dh, dh.

**Detyra:** leximi i tekstit, përshkrimi në fletore

**Klasa e 2, 3, 4 :** leximi i tekstit përkatës:

Gjëegjëzat.

Teksti: Letërsi shqiptarë N-1, faqe 18 dhe N-2 faqe 31/32

Lexim teksti ku fshihet enigma që kërkohet nga disa nxënës.

Pyetje konkrete rreth materialit: Cila nga gjëegjëzat që të kanë pëlqyer më shumë?

Mësoje ta thuash vetë para shokëve. Përktheje në gjuhën e shkollës.

Mundohu ta shkruash vet një gjëegjëzë – merr parasysh një shtazë, objekt, gjësend, profesion.

-Nga përshkrimi i gjëegjëzave, shpjegimet që kërkohen nxënësit (Gr-2 e 3)

**Dhia dhe shtatë kecat**

Dhia kishte shtatë keca. Çdo ditë ajo i porositte të kenë kujdes. Ujku ishte linzar i pabesë. Keci i madh - lëhnaku. Keci i dytë - Bardhoshi. Keci i tretë - Dhëmbaci. Keci i katërt - Dredhaku. Keci i pestë - Drudhaji. Keci i gjashtë - Dardhaku. Keci i shtatë - Kërpudhiani. Më i dituri ishte i shtati.

Detyrë: shkruaj emrat!

Keci i madh quhej lëhnaku.  
Keci i dytë quhej Bardhoshi i treti Dhëmbaci.  
i katërti Dredhaku pesti Drudhaji.  
i gjashti Dardhaku dhe i fundit quhej Kërpudhiani.

Xhevat Syla  
Shefikje Islama  
Riza Sheqiri

Për nivelin e dytë

**LETËRSI SHQIPTARË**

**GJËEGJËZA**

\*  
Ka samar e s'është gomar.  
\*  
Krejt rrita i shkon te qafa.  
\*  
Falë urtisë së vet,  
zotëron tokë e det.  
Dhëmbët i ka si sharrë  
me hënën ka të ngjarë.  
Shkon me pi ujë,  
vjen pa pi ujë.  
As hahet, as pihet –  
Pa të nuk rrihet.  
\*  
Ni sen i zi –  
E ruan ni shtëpi.  
\*

te renditje të ndryshuar:  
rrotat e qerres, girirafa  
bona, merimanga, çetësi, drapri

Riza Sheqiri  
Shefikje Islama  
Xhevat Syla

Për nivelin e parë

**LETËRSI SHQIPTARË**

**GJËEGJËZA**

Rrumbullak, strumbullak,  
Ka shtatë vrima rreth e qark.  
Shumë këmbë ka.  
Por asgjë nuk ha.  
Një patë qafëgjatë  
duke ikur bën shamatë.  
Flet me ty, por nuk ka zë.  
E do fort e rri me të.  
Kudo vete,  
Shtëpinë me vete.

Nexhat Maloku  
Rifat Hamiti

Për nivelin e parë

**UNË DHE TË TJERËT**

12. Shtatë motrat

Një natë gjyshi na tha: Sonte do fja tregoj  
disa gjëegjëza. Dëgjoni dhe gjyshi dhe fllatë:  
Përni motra mojtësi heshkë bëni plus.

**Loja: Imitimi** nga një nxënës, tjetri e gjenë dhe e shkruan emrin në tabelë Cili grup fiton shpërblehet me pikë në regjistrin e grupeve deri në kuotën shpërblyese.

**Përfundimi:** Rileximi, përshkrimi, faqja në internet, biseda me prindër rreth gjëgjëzave (kashelasheve).

**Detyrë shtëpie:** Leximi dhe gjetja e gjëgjëzave nga materiali mësimor i dhënë: Gjëgjëzat dhe në internet.

